



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:149443

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05482946

C.nr.246/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, i përbërë nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike të paditësit H.G. nga fshati..., komuna Skenderaj ne të cilin e përfaqëson me autorizim Xh.S. avokat në Prishtinë, me adrese ne rr..., kundër të paditurës Posta e Kosovës sh.a, rr. “28 Nëntori”, nr.4 në Dardani, me seli në Prishtinë, te cilën e përfaqëson me autorizim E.A. nga Prishtina, për anulimin e vendimit mbi suspendimin e përkohshëm nga marrëdhënia e punës dhe kompensimin e dëmit, kompensimin e diferencës në paga si dhe dëmin jo material, pas përfundimit te seancës se shqyrtimit kryesore me datë 05.12.2023 me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse, me datë 19.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.G. nga fshati..., komuna Skenderaj.

II. ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi i te paditurës Posta e Kosovës Sh.A. me nr. 01-1202 i datës 07.06.2022.

III. DETYROHET e paditura Posta e Kosovës sh.a me seli në Prishtinë qe paditësit H.G., t’ia kompensoj dëmin material për diferencën në pagat e pa paguara (te ardhurat personale) për periudhën e suspendimit prej dy muaj nga dt.25.02.2022 deri me dt. 24.04.2022 ne shumën prej 741.22 euro, në emër të Trust-it nga punëdhënësi shumën prej 18.53 euro, në emër të Trust-it nga punëmarrësi në shumën prej 18.53, në shumen e përgjithshme prej 778.28 euro (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë njëzetë e tetë).

IV. DETYROHET e paditura Posta e Kosovës qe paditësit H.G., ne emër te demit jo material për dhimbjet shpirtërore që i ka pësuar paditësi prej vendimit të kundërligjshëm te të paditurës, ti shpërblej shumen prej 10,000.00 euro.

Gjithsejte në shumen e përgjithshme prej 10,778.28 euro, që duhet te paguhet me kamatën ligjore ne normën prej 8% për dëmin jo material nga dita e marrjes se aktgjykimit 19.12.2023 ndërsa për dëmin material nga dita e ushtrimit te padisë me date 21.07.2022, ne afatin prej 7 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi.

V. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë qe ka te bëje me dëmin jo material mbi shumën e gjykuar, ngase shuma e kërkuar është e larte ne raport me dëmin e pësuar.

VI. OBLIGOHET e paditura që paditësit ti kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për hartim te padisë 204 euro, për përfaqësimet e avokatit ne pese seanca nga 104 euro

për ekspertizë të psikiatrisë shumë prej 200 euro, për ekspertizë financiare shumë prej 150 euro, ne shumë e përgjithshme prej 1,110 euro, ne afatin prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Paditësi në padinë e ushtruar në gjykatë përmes përfaqësuesit në autorizim me datë 21.07.2022, ka theksuar se është i punësuar tek e paditura me kontratë të përhershme të marrëdhënies së punës. Padia ka të bëjë me anulimin e vendimit të nxjerrë nga e paditura nr. 01-1202 të datës 07.06.2022, me të cilin paditësi përkohësisht është larguar nga puna sipas vendimit nr. 01-393/2022 të datës 24.02.2022, në kundërshtim me kontratën e rregullte të punës nr. 01-3255/14 të datës 22.09.2014. Me tutje ka theksuar se me datë 12.07.2022 paditësi ka pranuar vendimin e komisionit të ankesave të të paditurës nr. 01-1493/2022 datë 07.07.2022, me të cilin komisioni i ankesave e kanë refuzuar ankesën për anulimin e vendimit të komisionit disiplinor të paditurës nr. 01-1202/2022, datë 07.06.2022 ashtu që e paditura përmes përgjegjës të datës 07.07.2022, ka dështuar të nxjerre vendimin meritore me arsyetim absolut se paditësi kishte paralizuar padinë në gjykatë për shkak se sipas vlerësimit të tij legjitim pret drejtësi në rastin e tij. Fakti se paditësi është në marrëdhënie të përhershme të punës nga e paditura dëshmohet me kontratën e punës nr. 01-3255/14, të datës 22.09.2014. Paditësi asnjëherë deri në vendimin e nxjerrë kundërligjshëm nga e paditura, asnjëherë nga eproret mbikëqyrës apo me anë të ekzekutiv nuk ka pranuar asnjë vërejtje qoftë me të vogël në përmbushjen e detyrave të punës, në bazë të kësaj konstatohet se ka pasur performancë pozitive deri në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm nr. 01-393/2022 datë 24.02.2022 për largim të përkohshëm nga vendi i punës edhe pse ka pasur vlerësim të kryerjes së detyrave të punës mbi 90%. Me tutje është theksuar se nga i tere procesi i marrjes së vendimit nga e paditura rezulton se paditësi e ka përmbushë anën e tij sipas kontratës kështu që vendimi i kundërligjshëm dhe arbitrare i largimit nga puna është vërtetuar edhe nga vendimi i komisionit disiplinor i të paditurës kështu që i është shkaktuar dëm jo material dhe material paditësit. Paditësi me datë 08.06.2022 ka pranuar vendimin e komisionit disiplinor të paditurës nr. 01-1202 të datës 07.06.2022, përmes së cilit janë shqiptuar dy masa disiplinore: largim për dy muaj nga puna prej datës 05.02.2022 deri me datë 25.04.2022, dhe i është ndaluar avancimin – promovimet për një vit. Me këtë vendim iu kanë cenuar edhe të drejtat nga marrëdhënia e punës. Përmes padisë është kërkuar që të anulohet vendimi i lartë përmendur dhe të detyrohet e paditura që të shpërblejë paditësit dëmin jo material në shumën prej 30,000.00 euro si dhe dëmin tjetër material që do të vlerësohet me ekspertizë përkatëse.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datën 02.08.2023, paditësi përmes përfaqësuesit me autorizim u deklarua se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj duke shtuar se në cilësi të provave gjykatës i dorëzon CD dhe USB ku mund të konstatohet me zë dhe figure deklarimi i M.H. në T... K... që e pranon fajin për shkaktim të dëmit si dhe provat materiale raportet mjekësore ku dëshmohet se paditësi për shkak të dhimbjeve shpirtërore që i ka përjetuar me rastin e largimit të përkohshëm – suspendimit nga marrëdhënia e punës të shpërndarjes së lajmit në mjetet e informimit ka pësuar dëm jo material në pikëpamje shëndetësore dhe për reputacionin e tij personal dhe të familjes. I propozoi gjykatës nxjerrjen e provës me ekspertizë nga fusha mjekësore e psikiatrisë për vlerësimin të dëmit jo material, dëgjimin e dëshmitareve si dhe propozoi nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare për të konstatuar lartësinë e dëmit material.

Pas nxjerrës së provave të propozuara dhe përfundimit të administrimit të tyre në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe në elaboratin e saj në seancës kryesore me datë 05.12.2023, deklaroi se në çështjen konkrete juridike konsideron së është vërtetuar në tërësi gjendja faktike e përshkruar në padi dhe kërkesëpadi dhe në tersi mbetet pranë precizimit të

padisë se dorëzuar ne gjykatë me date 05.12.2023, ashtu që kërkoi që ne emër te demit material, shumën prej 778.28 euro, diferencën ne pagat e pa realizuara nga data 05.02.2022 deri me date 24.04.2022, për dëmin jo material ne emër te dhimbjeve shpirtërore kërkoi shumen prej 30,000.00, i kërkoi shpenzimet e procedurës kontestimore prej 760 euro, me tutje u deklarua se me provat administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor sidomos dëgjimin dëshmitareve, deklaratat e te cilëve janë evidentuar me procesverbalet dt. 11.09.2023, 02.08.2023, 16.03.2023, dhe 30.10.2023, janë vërtetuar pretendimet paditësit se kërkesëpadija është e themeltë juridikisht dhe bazuar ne gjendjen faktike ku paditësit me vendimin e kundërligjshëm numër 01-1202 te datës 07.06.2022, i janë shkelur te drejtat themelore nga marrëdhënia e punës me ç'rast i është shkaktuar dëm jo material dhe dëm material qe është vërtetuar me ekspertize te psikiatrisë te datës 21.09.2023, dhe me ekspertize financiare te datës 22.11.2023 kështu qe e paditura ka vepruar në kundërshtim me LMD neni 9, 136,137 dhe 133. I propozoi gjykatës qe pas vlerësimit te provave te administruara te merr aktgjykim me te cilin do te anulohet vendimi i kundërligjshëm dhe paditësit ti shpërblehet dëmi material dhe jo material ne lartësinë e precizuar me kërkesëpadi. I kërkoi shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumen e përgjithshme prej 760 euro si dhe për ekspertizën e psikiatrisë dhe atë financiare.

E paditura përmes përgjigjes ne padi te dorëzuar ne gjykatë me 14.07.2023, është deklaruar se e kundërshton ne tërësi kërkesëpadijën e paditësit si te pa bazuar sepse është ne kundërshtim me dispozita e nenit 253. 1 te LPK-së, ngase e njëjta ne petitum nuk përmban kërkesë ne pikëpamje te çështjes kryesore dhe aksesore dhe nuk përmban baze faktike dhe juridike, për këto arsye padija është e pa kuptueshme dhe si e tille gjykata ne kuptim te nenit 99 paragrafi 2 dhe nenit 102 te LPK-së, duhet te hedhë poshtë. Pretendimi ne padi se masa disiplinore te shqiptuar me vendimin e komisionit disiplinor numër 01-1202/2022 date 07.06.2022, qe sipas paditësit është e kundërligjshme dhe pa baze ligjore duke i propozuar anulimin e këtij vendimi dhe kompensimin e 1/2 te ardhurave personale te largimit te përkohshëm nga puna kthimit ne pune sipas kontratës se punës, nr. 01-3235/14, date 22.09.2014 përfshirë këtu edhe kompensimin për satisfaksion ne shume prej 30,000.00 euro. Deri te shqiptimi i masës disiplinore nga e paditura ndaj paditësit ka ndodhe pas zhvillimit te procedurës disiplinore për shkak se paditësi me veprimet e tij si kontrollor i ZP ne Skenderaj ka bere shkelje disiplinore te detyrave te punës nga neni 7.1 pika 1.6, 1.18,1.20,1.21, dhe 1.22 te Rregullores Për Përgjegjësinë Disiplinore Dhe Materiale numër 01-2605/21 date 26.10.2021. Parregullsitë ne procesin e punës te postes ne Skenderaj janë konstatuar nga inspektorët postar te cilët ne raportin e tyre numër 01-355/2020, date 23.02.2022 me rastin e inspektimit kane konstatuar keqpërdorim financiar te mjeteve te I...“I...” ne ketë poste ku është konstatuar mungesa e mjeteve prej 11,044.70 euro, mjete qe kane qene te dedikuara për dhënien e kredive te klientëve veprime këto te kryera nga M.H. si zyrtar financiar ne regjionin e Mitrovicës dhe arkëtari i zyrës postare ne Skenderaj V.Z.

Komisioni disiplinor gjate procedurës se zhvilluar dhe administrimit te provave ka konstatuar se paditësi ne pozitën e kontrollit te zyrës postare ne Skenderaj nuk ka dëshmuar te kundërtën e asaj qe është gjetur nga konstatimet e raportit te inspektoreve postar numër 01-355/2022, te datës 23.02.2022 i cili vazhdimisht nuk ka përmbushë detyrat dhe përgjegjësit e tij te parapara me rregulloren për sistematizimin dhe përshkrimin e detyrave te punës te nivelit regjional numër. 01-2720/16 dt. 20.09.2016. Duke u mbështetur ne thëniet ne përgjigjen ne padi i propozoi gjykatës qe kërkesëpadijën e paditësit ta refuzoj ne tersi si te pa bazuar si dhe te obligohet paditësi qe te paditurës te ia kompensoj te gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore.

Ne seancën përgatitore me date 02.08.2023, u deklarua se mbeten ne tërësi pranë përgjegjës ne padi duke shtuar se me rastin e inspektimit është konstatuar keqpërdorim i mjeteve financiare ne shumen prej 11,044.70 euro, qe kane qene te dedikuara pre I... C..., veprime këto te kryera nga M.H. zyrtar financiar ne regjionin e Mitrovicës dhe arkatari i postes ne Skenderaj V.Z., ku kjo

humbje ne mënyre kronologjike është përshkruar ne raportin e inspektoratit postar dhe mbi këtë baze komisioni disiplinor me vendim numër 01-1202/2022, date 07.06.2022, e ka bere përgjegjës paditësin ne përputhje me nenet e rregullore për përgjegjësinë materiale për punonjësit e PK numër 01-2605/2021. Bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje dhe provat e bashkëngjitura, përgjegjës ne padi dëshmohet shkelja e detyrave te punës qe është gjetur nga komisioni disiplinor dhe janë shqiptuar masat disiplinore nga komisioni kompetent.

Gjatë shqyrtimit kryesor u deklarua se mbetet pranë përgjegjës ne padi dhe deklarimeve nga seancat e kaluara. Ne fjalën përfundimtare te dorëzuar me shkrim me datë 05.12.2023 dhe elaboratin gjate seancës se shqyrtimit kryesor u deklarua se te gjitha provat e administruara ne këtë çështje kontestimore vërtetojnë se kërkesëpadisë se paditësit i mungon baza ligjore dhe si e tille nuk është vërtetuar me asnjë prove materiale, përmes se cilave do ti vërtetonte pretendimet e tij paditësi ngasë vendimet e kontestuara kane ardhë si rezultat i procedurës disiplinore sipas se cilës janë vërtetuar shkeljet e detyrave te punës se paditësit ne pozitën te cilën e mbanë “kontrollor i zyrës postare ne Skenderaj”, ne posten regjionale ne Mitrovicë. Gjithashtu është vërtetuar se i njëjti ne rastin konkret ka bere shkelje disiplinore te detyrave te punës te përcaktuar me nenin 7.1 pika 1.6, 1.11, 1.18, 1.20, dhe 1.21 te rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore nr. 01-2605/21 date 26.10.2021. Me rastin e inspektimit te zyrës se postes ne Skenderaj është konstatuar mungesa financiare ne shumen prej 11,044.70 euro. Ne zyrën postare ne Skenderaj pozita e kontrollorit te postes është një pozite kyçëse dhe kryesore ne zyrën postare pas përgjegjësit kryesor ne mënyrë për mbarëvajtjen te procesit te punës. Mungesa e mjeteve financiare ne shumen prej 11,044.70 euro, ka ndodhur ne mënyrë kronologjike pasqyruar ne raportin e inspektoreve postar nr. 01-355/2020 te datës 23.02.2022, siç është theksuar edhe ne përgjigjen ne padi dhe gjatë seancave gjyqësore e paditura pretendon se paditësi edhe me pare me apo pa vetëdije ka fshehur pa rregullsitë e ndodhura ne fund te viti 2017 përkatësisht 2018 kur ka mbuluar keqpërdorimin financiare ne shumen prej 10,515 euro te ish arkëtarit V.M. tani i ndjere, duke mos iu lajmëruar menaxhmentit e PK Sh. A dhe as policisë qe i ndjeri ka tentuar përvetësimin ne mënyre te kundërligjshme. Me tutje ne fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësi me asnjë prove te vetme nuk ka arrite qe ta provoj besueshmërinë juridike te kërkesëpadisë ne dispozitat ligjore qe kërkon anulimin e vendimit te përmendur me lartë nga shkeljet disiplinore. Për te gjitha arsyet e theksuara gjate procesit gjyqësor i propozoi gjykatës qe padinë paditësit ne mungese te bazës ligjore dhe pa mbështetjes se saj ne provat materiale ta refuzoj ne tërësi si te pa bazuar duke e obliguar paditësin qe ti kompensoj te gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata me qellim te konstatimit te drejtë dhe te plote te gjendjes faktike ne çështjen konkrete juridike ne kuptim te nenit 7 dhe 8 te LPK-së, i nxori dhe administroi te gjitha provat e propozuara nga ndërgjyqësit qe janë administruara gjate seancave të shqyrtimeve kryesore si dhe provat materiale te administruara ne seancën e shqyrtimit kryesor me date 05.12.2023, një nga dhe te gjitha se bashku, duke i krahasuar njëërën me tjetrën, nga te cilat rezulton se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë.

Me provat e administruara rezulton se ne mes te palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka themeluar marrëdhënie te punës ne kohe te pa caktuar te e paditura sipas kontratës me nr.01-3235/2014 me dt.22.09.2014, po ashtu nuk është kontestues fakti se Drejtoria e Inspektoreve Postar te Kosovës ka kryer inspektim ne zyrën postare ne Skenderaj qe dëshmohet ne raportin nr.01-355/2022 dt.23.02.2022. Mbi bazën e këtij raporti e paditura ka nxjerrë vendimin nr.01-395/2022 dt.24.02.2022 për largim te përkohshëm te paditësit nga vendi i punës deri në vendimin e ardhshëm nga komisioni disiplinor. Po ashtu nuk është kontestuese se e paditura ka nxjerrë vendimin përmes komisionit disiplinor nr.01-1202/2022 dt.07.06.2022 me te

cilin mbi bazën e te gjeturave te pretenduara i është shqiptuar masa disiplinore largim i përkohshëm për 2 muaj paditësit nga dt.25.02.2022 dhe i ndalohet avancimi (promovimi) për një vit.

Kontestuese ne mes te palëve ndërgjygjëse mbesin faktet për ligjshmërinë e vendimi mbi largimin e përkohshëm dhe suspendimin e paditësit për 2 muaj nga puna dhe masa e ndalimit të avancimit ne kohëzgjatje te 1 viti si dhe lartësia e kërkesëpadisë sa i përket dëmit.

Ne shkresat e lendes paditësi i ka dorëzuar gjykatës formularin për vlerësimin e performancës qe përfshin periudhën nga dt.01.01.2019 deri me dt.30.06.2019, ku është pasqyruar vlerësimi i punës se paditësit, gjate kësaj periudhe ka pasur vlerësime shumë te mira dhe e ka përmbushur normën e detyrave të punës prej 80%. Ne raportin e vlerësimit te performancës për periudhën e dyte nga dt.01.07.2019 deri me dt.31.12.2019, paditësi është vlerësuar nga e paditura se me sukses i ka përmbushur detyrat e punës prej 95 %. Edhe nga formulari për vlerësimin e performancës për periudhën nga dt.01.07.2021 deri me dt.31.12.2021 paditësi është vlerësuar se i ka përmbushur detyrat e punës prej 92%. Nga këto vlerësime te bëra nga eprori mbikëqyrës i te paditurës ku është pajtuar me aktin e nënshkrimit edhe vet paditësi rezulton se gjatë kësaj periudhe paditësi ka treguar performancë te shumë mirë ne kryerjen e detyrave te punës, prandaj nga këto prova konstatohet se e paditura paditësin e ka vlerësuar shumë mirë në kryerjen e detyrave të punës.

Se paditësi detyrat e punës qe dalin nga kontrata e punës i ka kryer në plotni vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitares K.K. udhëheqëse në zyrën postare në Skenderaj e cila deklaroi se bashkë me paditësin janë ne marrëdhënie pune qe 20 vite në Postën e Kosovës, dhe se i njëjti është vartësi i saj njëherit është edhe zëvendës, duke shtuar se gjate punës se tij asnjëherë nuk ka hasur ne ndonjë parregullsi, fshehtësi apo shkelje disiplinore, punën e ka ushtruar me profesionalizëm te plotë. Vlerësimin për punën e paditësit e ka vlerësuar prej 90% qe i përgjigjet vlerësimit real. Dëshmitarja me tutje ka theksuar se paditësi nuk ka pasur qasje ne sistemin “I... C...” qe është shërbim i veçantë ne te cilin ka qasje vetëm arkëtari, financat regjionale dhe niveli qendror.

Me vlerësimin e pretendimeve të palës paditëse, shkresave të lëndës dhe dëshmisë së dëshmitares që kanë të bëjnë me faktet se gjate ushtrimit te detyrave te punës paditësi a ka vepruar ne përputhje me kontratën e punës, Ligjin e Punës dhe rregulloret e brendshme gjykata gjënë se i njëjti i ka respektuar aktet e njëjta duke vepruar konform detyrave dhe përgjegjësive të punës. Komisioni disiplinor nuk ka arritur te faktojë se paditësi ka rënë ne kundërshtim me kontratën e punës ku janë përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e tij ne raport me punëdhënësin. Për periudhën ku pretendohet se paditësi edhe ne vitin 2017-2018 nuk i ka kryer detyrat e punës me arsyetim se “ e ka heshtë” minusin e mjeteve ne te holla prej 10,000 euro qe kinse është keqpërdorur nga arkatari i ndjerë V.M. e disa raste thuhet se ka dashur ti keqpërdorë, këto dy kuptime si keqpërdorje dhe tentim keqpërdorje konstatohet se nuk janë të provuara me asnjë provë, ashtu qll nuk konkretizohet data e konstatimit të mungesës, nuk sqarohet pse arkatari V.M. nuk është përballë me përgjegjësi disiplinore apo ndonjë masë tjetër në raport me përgjegjësinë e pretenduar apo të provohet me fakte se procedura e filluar ndaj arkatarit është pushuar për shkak të vdekjes. Sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim që ka për qëllim vënien në dyshim të punës së paditësit dhe nuk është provuar me asnjë provë materiale nga e paditura.

Dëshmitari Sh.F. shef i inspektoratit postar me seli ne Prishtinë, ka deklaruar se ne baze te kërkesës se kryeshefës ekzekutive F.A. është bere inspektimi financiar ne zyrën komunale postare ne Skenderaj i cili kontrolle është kryer me dt.25.01.2022. Me tutje ka sqaruar se mungesa e mjeteve financiare e “I...C...” ka qene e periudhës kohore 2018 dhe 2022. Ne pyetjen

e përfaqësuesit të paditësit se “a keni ushtruar kontroll inspektues gjatë këtyre viteve 2018,2019,2020,2021” dëshmitari ka sqaruar se kanë bere inspektime dhe raportet i kanë dorëzuar, por janë bere për segmente të ndryshme, në rastet e jashtëzakonshme kanë shkuar me inspektim me autorizim nga shërbimi kontabilist i postës e ka ngritur këtë shqetësim. Gjate kontrollimit inspektues askund nuk kemi konstatuar në raport se keqpërdorimi i mjeteve është bere nga H.G., por vetëm kemi konstatuar se ka munguar kontrolli dhe mbikëqyrja nga ana e tij pasi që udhëheqësi financiar regjional M.H. dhe V.Z. si arkatar kanë pranuar keqpërdorimin e mjeteve.

Dëshmitari N.M. në dëshminë e tij ka theksuar se ka qene koordinator për integrimin e minoriteteve në posten regjionale në Mitrovicë, dhe me dt.25.02.2022 nga meangjëmti i Postës së Kosovës kam pranuar detyrën e ushtruesit të detyrës së menaxherit regjional të postës në Mitrovicë dhe rrjedhimisht kam qene edhe epror i paditësit. Me dt.25.02.2022 rreth orës 16:30 kam kontaktuar me telefon me paditësin duke e njoftuar se unë po nisem për në Skenderaj sepse jam emëruar si menaxher i postës. Qëllimi i vizitës ka qene shikimi i procesit të pranimit dorëzimit të detyrës së përgjegjësit të postës, kontrollorit dhe arkatarit sepse dihte me parë kishte ndodhur suspendimi i tyre dhe unë nuk kam pasur vendim me shkrim për suspendimin e vartësve të mi dhe nuk jam njoftuar me shkrim por vetëm përmes telefonit nga drejtoria operative - drejtoresha S.A. Gjate kryerjes së punës nuk kam pasur pjesëtar të Policisë së Kosovës por vetëm hetues të prokurorisë dhe sjelljet e paditësit ndaj meje dhe të pranishmit kanë qene korrekte por vetëm është vërejtë se ka qene i shqetësuar. Gjate periudhës kohore që kam qene në pozitë të eprorit ndaj paditësit në baze të komunikimeve e takimeve, paditësi me përpikëri i ka realizuar detyrat e punës konform përshkrimit të detyrave me rregullore për atë kohë sa kam qene përgjegjës.

Dëshmitari S.Sh. shef i kontrollit të brendshëm të postës së Kosovës ka deklaruar se autorizimin për ushtrim të kontrollit e ka marrë në kryeshefja F.A. për shkak të një mungese financiare, dhe me dt.25.02.2022, me takim me kryeshefën me ka thënë se dy zyrtarë të postës në Skenderaj janë të suspenduar dhe pikërisht për këtë qëllim duhet të shkuar në posten në Skenderaj sepse është krijuar tollovi me shikua se çfarë po ndodh, me shkrim nuk kemi pasur informacion. Kur kemi ardhur gjendja ka qene normale, pak e tensionuar dhe dy koleget kanë qene të shqetësuar për vendimet që i ka marrë posta. Pasi që e kemi përfunduar punën rreth orës 21:30 minuta kemi dalë nga zyra komunale postare dhe i kemi njoftuar të nesërmen kryeshefen për qëndrimin në Postë.

Nga këto dëshmi gjykata vërteton se paditësi edhe para kontrollit inspektues për punën e tij ka raportuar në mënyrë periodike të eprorit sipas akteve të brendshme dhe nuk kanë pas vërejtje në punën e paditësit. Nga këto dëshmi është provuar fakti se edhe pse vendimi i largimit të përkohshëm është nxjerrë pa përfillje të rregulloreve të brendshme sa i përket pranimit dorëzimit të detyrës së arkatarit në ZP në Skenderaj paditësi e ka zbatuar vendimin për largim nga vendi i punës.

Nga këto vërtetohet edhe fakti se konstatimet e komisionit disiplinor gjoja për pengesë në largim nga vendi i punës nga paditësi, nuk qëndron pasi që kjo është demantuar plotësisht nga dëshmia e dëshmitarit N.M.

Se vendimi mbi suspendimin e paditësit përkohësisht për 2 muaj dhe ndalimi në avancimin e tij për 1 vit është i nxjerrë plotësisht në kundërshtim me faktet dhe provat e administruara që u përmenden më lartë, vërtetohet edhe me faktin se vet M.H. - zyrtar regjional financiar personalisht e ka pranuar fajin në K... K..., prove materiale e administruar përmes CD përmes së cilës konstatohet se ai i ka keqpërdorur mjetet financiare dhe për shkakun e kësaj mungese janë marrë masat disiplinore ndaj paditësit.

Në rastin konkret nuk është kontestues fakti se M.H. zyrtar regional i financave është fajtor i mungesës së mjeteve financiare së bashku me arkëtarin e zyrës postare në Skenderaj V.Z. sepse përveç pranim të tyre në lidhje me mungesën e mjeteve financiare, mungesa ndër tjera është vërtetuar me kontroll inspektues, kështu që përgjegjësia direkte në raport me të gjeturat e organit kompetent të brendshëm dhe detyrat e punës bie në barrën e kryesve të aktit në fjalë dhe në asnjë mënyrë nuk është i mbështetur akti i suspendimit të paditësit me masë të ndalim avancimit në aktet e brendshme të punëdhënësit dhe Ligjin e punës.

E paditura me shqiptim të masave disiplinore të largimit të përkohshëm nga puna me vendim nr.01-393/22 të dt.24.02.2022 ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale nr.01-2605/21 të dt.16.10.2021 me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 ku parashihen shkaqet e largimit të punëtorit nga puna ku thuhet *“I punësuari mund të largohet përkohësisht nga puna:*

- 1.1. Nëse ndaj tij ka filluar procedura penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale.*
- 1.2. I punësuari është në arrest burg.”*

Po ashtu e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 73 të Ligjit të Punës nr.03.L/212 nga se nuk janë plotësuar asnjëri prej kushteve ligjore për shqiptim të masave disiplinore largim i përkohshëm nga puna.

Referuar masave disiplinore të shqiptuara ndaj paditësit, faktit se përgjegjësia e të punësuarve është individuale në raport me punën e tyre, e në anën tjetër e paditura gjatë kohës kur ka ndodhë mungesa e mjeteve ka ushtruar kontrollat të rregullta por nuk ka gjetë mungesë të mjeteve dhe as paditësi, prandaj masat disiplinore janë të rëndë dhe jo proporcionale në raport me përgjegjësitë dhe detyrat e punës së paditësit si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 85 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 ku parashihen masat disiplinore për shkeljet e detyrave të punës.

Mbështetur në këto arsye faktike të vërtetuara me prova gjykata konstaton se vendimi i të paditurës për largim të përkohshëm dhe i komisionit disiplinore me nr.1202021/2022 i dt.07.06.2022, me masat e shqiptuara është i kundërligjshëm dhe paditësi me të drejtë ka kërkuar mbrojtje gjyqësore për anulimin e tij dhe shpërblim të dëmit të pësuar nga akti dëmtues, në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 79 të Ligjit të Punës nr.03/L-212.

Meqenëse pa mëdyshje është vërtetuar se paditësi ka përjetuar dhimbje shpirtërore si pasojë e vendimit të kundërligjshëm të nxjerrë nga e paditura, gjykata duke marrë për bazë provat në shkresat e lëndës - raportet mjekësore që e provojnë se paditësi prej momentit të marrjes së këtij vendimi ka pasur probleme shëndetësore, për vërtetimin e këtyre fakteve e ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e psikiatrisë nga eksperti Dr. Sh.H.

Eksperti mjekësor pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës ka dhënë mendim dhe konstatim profesional me shkrim dhe duke u bazuar në rrethanat e rastit konkret ka vlerësuar se si pasojë e vendimit të të paditurës paditësi ka përjetuar shqetësime shpirtërore dhe atë:

dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë janë manifestuar me habi, hezitim, ulje apo rënie të disponimit, ulje të vullnetit të përgjithshëm, pagjumësi dhe nervozë, shqetësime të karakterit ankioz të përcëlluara me shtrëngim në gjoks, çrregullim të ritmit të zemrës, aritmi etj. Gjithë kjo pasi që është një person me autoritet, kredibilitet dhe përnjëherë ka ardhur në një situatë të shkeljes së ligjit, fillimit të dyshimit në sistem (Posten e Kosovës) bashkëpunëtor dhe kolegë, ku e gjithë kjo ka sjellë në një konstatim se ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë

ne kohëzgjatje prej 1 muaj. Dhimbjet te intensitetit te mesëm kanë zgjat 5 muaj tjerë vijues te shoqëruara me shqetësime te karakteri ankciroz, nervozë, agresivitet, pagjumësi, fjalosje te vazhdueshme me familjaret, raportet e brishta me miq dhe dashamire, mendime negative për rrethin dhe për vete, krejt kjo si pasoje e mos përballimit te njolloshjes se personalitetit dhe integritetit te tij ne raport me familjaret, miqtë dhe kolegeve te punës. Dhimbjet shpirtërore te intensitetit te ulet kanë zgjat 6 muaj me simptomat e larte cekura por me intensitet me te ulur ne fazat e kohe pas kohshme.

Eksperti mjekësor ka dhëne sqarime me ekspertin ne seancën e dt.05.12.2023 ndaj te cilës pala paditëse u deklarua se nuk ka vërejtje ndërsa pala e paditur pas pyetjeve te parashtruara ekspertit dhe marrjes se përgjigjes u deklarua se nuk ka vërejtje ne mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën mjekësore dhe e mori si prove te besueshme ngase eksperti me argumente profesionale dhe shkencore ka konstatuar se tek paditësi është manifestuar frika me intensitet dhe kohëzgjatje për një kohë të caktuar dhe gjykata e mori si prove vendimtare mbi bazën e secilës është konstatuar ekzistimi i demit moral - jo material qe e ka pësuar paditësi ne rastin konkret, prandaj bazuar në konstatimin e ekspertit dhe duke i marrë për bazë rrethanat e rastit konkret dhe kriteret tjera vlerësuese, kryesisht të mirën e cenuar është aprovuar shumja prej 10,000.00 euro duke u bazuar në dispozitat e nenit 183 paragrafi 1 i LMD-së nr.04/L-077 ku është përcaktuar se *“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak te zvogëlimit te aktivitetit jetësor, te shëmtimit, të cenimit te autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, te vdekjes se personit te afër, si dhe frikës, gjykata, po ta konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i demit material si dhe nga mungesa e demit material”*.

Meqenëse paditësi me vendimin e suspendimit nga dt.25.02.2022 deri me dt.24.04.2022, është kompensuar vetëm 50% nga paga bazë prej 778.28 euro fakt i cili nuk është kontestues ne mes te palëve, gjykata për te konstatuar ne mënyrë te drejte dhe te plotë demin material në mos pagesë të pagave për periudhën e suspendimit ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertin financiare nga eksperti S.D. i cili pas analizimit dhe vlerësimit te provave me shkresat e lëndës ka dhëne mendim dhe konstatim profesional dhe ka marre pjese ne seancën e shqyrtimit kryesor me dt.05.12.2023 për te dhëne sqarime e ne ekspertize.

Eksperti ne faqen e pare te ekspertizës ka bere përshkrimin ne baze te cilave fakteve ka mbështet mendimin e tij dhe periudhën kohore ndërsa ne faqen e dyte ne forme tabelore e ka paraqit pasqyrëzen e llogaritjes se pagave me dt.25.02.2022 deri me dt.24.04.2022 dhe ne ketë faqe ka paraqit pasqyrëzen përmbledhëse ku paga neto është 741.22 euro, pensioni i punëdhënësit 18.53 euro, pensioni i pune marrësit 18.53 euro kështu qe totali i dy pagave prej 50 % te perealizuar për dy muaj është ne shumen prej 778.28 euro, ne fund te ekspertizës eksperti ka sqaruar se ka marre për bazë periudhën e suspendimit te paditësit nga dt 25.02.2022 deri me dt.24.02.2022 konform kontratës se rregullt te punës nr.01-3235/2014 dt.22.09.2014 duke marre për baze gradën 6 sipas shkalles se te ardhurave personale te postes se Kosovës .

Nga ekspertiza rezulton se paga neto e paditësit është 741.22 euro, trusti pensional nga punëdhënësi është 18.53euro, trusti pensional nga punëmarrësi është 18.53 euro, gjithsejtë shumja për kompensim arrinë shumën 778,28 euro.

Palët ndërgjyqëse nuk e kundërshtuan ekspertizën financiare.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën financiare dhe e mori si prove të besueshme sepse ekspertiza i përmban të gjitha kriteret e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive dhe përvojës profesionale të ekspertit dhe gjykata e mori si prove vendimtare mbi bazën e se cilës e aprovoi dëmin – fitimin e munguar të paditësit.

Sa i përket demit material –fitimit të munguar gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 173 paragrafi 1 dhe 3 i LMD-së nr.04/L-077.

Gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së gjykuar për dhimbjet shpirtërore, ngase shumat e kërkuara janë të larta në raport me demin jo material të konstatuar nga eksperti mjekësor, ndërsa shuma e gjykuar është në pajtueshmëri të plote me të mirën e cenuar nga akti dëmtues i të paditurës me vendimet e kundërligjshme të të paditurës.

Gjykata i vlerësoi të gjitha kundërshtimet e paraqitura nga pala e paditur me përgjigje në padi seancë përgatitore, shqyrtime kryesore dhe në fjalën përfundimtare, por të gjitha këto kundërshtime sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë provuar me fakte dhe prova bindëse ngase demin që i kanë shkaktuar paditësit është rrjedhojë e vendimit të pa mbështetur në rregulloret e brendshme dhe Ligjin e Punës, prandaj këto kundërshtime nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala e paditur duhet të i barte shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për hartim të padisë 204 euro, për përfaqësimet e avokatit në pesë seanca nga 104 euro, gjithsejtë shpenzime të avokatit në shumën 760 euro, si dhe shpenzimet për ekspertizë të psikiatrisë shumën prej 200 euro, për ekspertizë financiare shumën prej 150 euro, për të cilat ekspertiza paditësi me prova – dëftesë pagesë ka vërtetuar se është kryer pagesa, prandaj detyrimi i të paditurës për kompensimin e shumës prej 1,110 euro është i bazuar në dispozitat e nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Me sa u tha me lartë konform të dispozitave ligjore materiale të cituara me lartë dhe dispozitave të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM.
C.nr.246/2022, me dt.19.12.2023**

**Gjyqtari
Hajrullah Aruqi**

UDHËZIMË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.